

VENDIM
Nr.653, datë 17.10.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.8, DATË 5.1.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË LUFTËS KUNDËR
TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët “Ministër i Shtetit-kryetar” zëvendësohen me “Ministër i Brendshëm-kryetar” dhe fjalët “Zëvendësministër i Rendit Publik-anëtar”, zëvendësohen me “Zëvendësministër i Brendshëm, për luftën kundër trafikeve–koordinator”.

b) Pika 3, shfuqizohet.

2. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Komiteti Shtetëror i Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave propozime për përmirësimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore.

3. Ngarkohet Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha